# K O N T R A T Ë

## PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## "ALBA PEN" TIRANË

### Neni 1

Z.Aziz Ozuolmez person fizik Turk me shtetësi dhe kombësi Turke, Z.Petrit Gorellari person fizik shqiptar në adresë pallatet Agimi shk.4, Ap.31 dhe Engjell Gorellari person fizik shqiptar adresë pallatet Agimi, shk.4 Ap.31, kanë krijuar një firmë private me qendër në Tiranë e quajtur ALBA PEN, miratuar si person juridik shqiptar me vendimin e gjykatës së Rrethit Tiranë, kanë vendosur që firma e sipërme të marë formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) duke shprehur kështu vullnetin e tyre të lirë.

### Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare, për shoqëritë tregëtare, si dhe të dispozitave të statutit të saj që i bashkëngjitet kësaj kontrate.

### Neni 3

Emërtimi i shoqërisë është "ALBA PEM" shpk Tiranë.

### Neni 4

Shoqëria ka për objekt të saj :

Veprimtari prodhuese në fushën e industrisë, ndërtimit, bujqësisë, material ndërtimi, tregëtim të artikujve të ndryshëm të konsumit të gjerë industrial, ushqimorë me shumicë e pakicë import-eksport, prodhim dyer dritare grilla etj., prodhime plastike, importi dhe eksporti i lëndëbe të para e materialeve

pajisjeve e makinerive, pjesë këmbimi, karburante e lubrifikante, shitje të të gjithë llojeve të mjeteve e pjesëve të këmbimit për to, mirëmbajtje e parkingu i tyre, grumbullimi, përpunimi e tregëtimi i produkteve bujqësore, blegtorale, bimë medicinale, prodhimet e pyllit, veprimtari në fushën e transportit të mallrave e udhëtarëve, turizëm, hapje kurse për shoferë, kambizëm, instalim të lojrave elektronike, komisioneri etj., veprimtari të parashikuara në statutin bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 5

Qendra dhe selia e shoqërisë është në qytetin e Tiranës pallatet Agimi, shk.4, Ap.31.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë e cila përbëhet nga kontribute në para të derdhura nga ortakët dhe i ndarë në 20 pjesë, ku secila pjesë ka një vlerë prej 5.000 lekë.

Në kapitalin themeltar Z.AZIZ OZUOLMEZ ka derdhur një kontribut në para prej 50.000 lekë dhe ka në këtë shoqëri 10 pjesë nga numuri 1 deri 10 Z.Petrit Gorellari ka derdhur një kontribut në para prej 25000 lekë dhe ka në këtë shoqëri 5 pjesë nga numuri 11 deri 16, dhe Engjëll Gorellari ka derdhur një kontribut në para prej 25000 lekë dhe ka në këtë shoqëri 5 pjesë nga numuri 16 deri 20.

Shumat e derdhura të kapitalit themeltar do të vërtetohen me mandatin e lëshuar nga banka për depozitimin e kontributeve në para.

Neni 7

Fitimet neto të realizuara do të ndahen në përputhje me

./.

përqindjen e pjesëve të kontributeve të derdhura nga secili ortak në kapitalin themeltar. Pra në përputhje me kapitalin e secilit ato do të ndahen 50% AZIZ OZUOLMEZ, 25% Petrit Gorellari dhe 25% Engjëll Gorellari.

## Neni 8

Shoqëria ka si administrator të përgjithshëm ortakun e kësaj shoqërie Engjëll Gorellari.

Kjo kontratë është hartuar në Tiranë në datën 20.2.1996.

PËR SHOQËRINË "ALBA PEM" SHPK

O R T A K Ë T :

(AZIZ OZUOLMEZ) ( PETRIT GORELLARI) (ENGJËLL GORELLARI )

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË

Nr. 1720 Rep.
Nr. 511 Kol.

## V Ë R T E T I M

Sot në datën 23.2.1996 (nëntëdhjetgjashtë), u paraqitën personalisht para meje noteres në Tiranë AZIZ OZUOLMEZ, Petrit Gorellari, Engjëll Gorellari ortakë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALBA PEM" me gjeneralitetet e mësipërme, madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar për identitetin e të cilëve u sigurova nga letër njoftimi personal, të cilët deklaruan se më sipër është vendim i ortakëve, përpiluar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, nënshkruhet rregullisht para meje dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

N O T E R E

NOTERE
ZEQINE SINA
TIRANE ALBANIA